

KORRIK 2025 Buletini CRED4TEACH Vëll. 2

Mësoni më shumë rreth projektit në:
www.cred4teach.eu



Çfarë është CRED4TEACH?


Projekti CRED4TEACH i përgjigjet nevojave të institucioneve të arsimit të lartë dhe vendimmarrësve në fushën e arsimit në Shqipëri, Mal të Zi dhe Ukrainë për të ofruar trajnime cilësore, të përshtatshme, gjithëpërfshirëse, fleksibël dhe të bazuara në kompetenca për mësuesit në detyrë në sektorë të ndryshëm arsimorë.

Zgjidhja e projektit është krijimi i programeve të shkurtra trajnuese të bazuara në MOOC, të ashtuquajtura Mikro-kredenciale, për të rritur mundësitë për zhvillimin profesional të mësuesve në vendet e synuara.

Objektivat e CRED4TEACH:

- Të përmirësojë aftësitë e stafit për hartimin dhe ofrimin e Mikro-kredencialeve të bazuara në MOOC;
- Të zhvillojë dhe të prezantojë kornizat kombëtare dhe institucionale për ofrimin, lëshimin dhe njohjen e Mikro-kredencialeve;
- Të krijojë, ofrojë dhe të vlerësojë 11 Mikro-kredenciale pilot të bazuara në MOOC;
- Të inkurajojë një zbatim më të gjerë të Mikro-kredencialeve në zhvillimin profesional të mësuesve dhe grupeve të tjera të synuara.

Rezultatet kryesore të CRED4TEACH dhe përparimi i tyre



Volumi i dytë i buletinit CRED4TEACH paraqet zhvillimet kryesore të projektit dhe pikat më të rëndësishme të vitit të dytë (qershor 2024 – maj 2025) në Shqipëri, Mal të Zi dhe Ukrainë.

Merrni kafën ose çajin tuaj dhe shijoni leximin!

✓ Konferenca e parë për projektin CRED4TEACH në Vlorë, Shqipëri

- ✓ Data e fillimit: 10 tetor 2024
- ✓ Data e përfundimit: 10 tetor 2024
- ✓ Ngarkesa e punës: 8 orë
- ✓ Formati: konferencë (prezencë fizike)
- ✓ Ndikimi: Konferenca rriti ndërgjegjësimin dhe mbështetjen për mikro-kredencialet e bazuara në MOOC tek mësuesit dhe aktorët arsimorë në Shqipëri.

Më 10 tetor 2024, Universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës organizoi konferencën e parë për projektin CRED4TEACH, me titullin **“Ndërtimi i kompetencave: Mikro-Kredencialet për zhvillimin dhe ekselencën e mësuesve”**. Në këtë event u mbledhën rreth 160 mësues shqiptarë dhe anëtarë të ekipit të projektit. Konferenca shërbeu si një platformë e rëndësishme mes profesionistëve të arsimit për të promovuar ndërgjegjësimin dhe kuptimin mbi Mikro-kredencialet e bazuara në MOOC. Diskutimet u fokusuan në zbatimin praktik të trajnimeve afatshkurtra, rëndësinë e bashkëpunimit midis mësuesve dhe aktorëve institucionalë, si dhe përputhshmërinë me kornizat dhe rregulloret përkatëse. Ngjarja theksoi potencialin e Mikro-kredencialeve për t’u integruar në mënyrë efektive në sistemet kombëtare të arsimit



dhe për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar në zhvillimin profesional të mësuesve.



✓ Takim ndërkombëtar i projektit në Talin

- ✓ Data e fillimit: 26 maj 2025
- ✓ Data e përfundimit: 27 maj 2025
- ✓ Ngarkesa: 20 orë
- ✓ Format: prezencë fizike

Më 26–27 maj 2025, partnerët e CRED4TEACH u mbledhën në Universitetin e Talinit në Estoni për takimin e katërt ndërkombëtar të projektit. Një fokus kryesor i agjendës ishte vlerësimi i gatishmërisë së secilit institucion partner për të pilotuar Mikro-kredencialet e bazuara në MOOC, me vëmendje të veçantë ndaj aspekteve teknike, akademike dhe administrative

Takimi shërbeu gjithashtu si një platformë për ndarjen e përvojave, shkëmbimin e praktikave më të mira dhe koordinimin mbi afatet kohore, përgjegjësitë dhe strategjitë e komunikimit për të siguruar dukshmëri të fortë dhe ndikim të qëndrueshëm.



Aspektet më të rëndësishme nga partnerët e CRED4TEACH:

UKRAINA

Universiteti Shtetëror Teknologjik Cherkasy (ChSTU)

Hapja e Studios së Medias për prodhimin e MOOC nga ChSTU

ChSTU ka inauguruar zyrtarisht studion e saj të shumëpritur të medias për regjistrimin e videove instruktive me cilësi të lartë, që përbëjnë një element thelbësor të kurseve interaktive online. Studioja e Medias është më shumë se një hapësirë – është një simbol i inovacionit dhe një angazhim i fortë për arsimin modern dhe të aksesueshëm.

Studioja ndodhet në sallën e strehës kundër bombave dhe shërben për dy qëllime kryesore: bllokon dritën natyrale, duke krijuar kushte optimale për regjistrim, dhe siguron një ambient të sigurt për njerëzit dhe pajisjet gjatë sulmeve ajrore potenciale – një realitet i ashpër i kohës së luftës në Ukrainë.


Edhe pse regjistrimet e para të ligjëratave u shoqëruan me disa probleme teknike, përvoja e përgjithshme ishte emocionuese dhe shpërblyese!



Mikro-kredenciali “Metodat krijuese të Mësimdhënies në Edukimin STEAM” në ChSTU

Mikro-kredenciali “Metodat krijuese të Mësimdhënies në Edukimin STEAM”, i hartuar për të rritur kapacitetin e edukatorëve për të aplikuar strategji krijuese dhe inovative të mësimdhënies në disiplinat STEAM, ka nisur zyrtarisht në ChSTU. Takimi fillestar për 26 pjesëmarrës pilot u zhvillua më 2 qershor 2025. Gjatë sesionit, drejtuesit e kursit prezantuan ekipet e instruktorëve, paraqitën përmbajtjen e kursit si dhe aspektet teknike të përdorimit të platformës të universitetit Moodle.

Fokus kryesor i takimit ishte motivimi dhe frymëzimi i pjesëmarrësve, duke vendosur një atmosferë bashkëpunuese dhe me vizion për rrugëtimin mësimor që po fillonte. Pjesëmarrësit shfaqën interes të lartë duke marrë pjesë aktive në diskutime mbi afatin kohor të trajnimit dhe format e vlerësimit. Duke qenë një grup pilot, reagimet dhe reflektimet e tyre do të luajnë një rol kyç në vlerësimin dhe përmirësimin e kursit në të ardhmen. Ekipi është i bindur se ky kurs do të jetë një përvojë profesionale me vlerë për të gjithë — dhe presim rezultate të shkëlqyera pas përfundimit të tij!



Prezantimi i projektit CRED4TEACH në Forumin e Partneritetit Social 2025 në Ukrainë

Më 12 mars 2025, ChSTU festoi 65-vjetorin e tij me një Forum të Partneritetit Social, duke mbledhur së bashku aktorë nga i gjithë rajoni, përfshirë punëdhënës, autoritete vendore, ish-studentë dhe staf të universitetit.

Ekipi i ChSTU e shfrytëzoi Forumin si një mundësi për të rritur ndërgjegjësimin mbi rolin e Mikro-kredencialeve të bazuara në MOOC në avancimin e zhvillimit profesional të mësuesve dhe forcimin e të menduarit krijues dhe aftësive të tjera thelbësore sociale. Forumi theksoi rëndësinë gjithnjë e në rritje të të mësuarit digjital ne formësimin e të ardhmes së sistemit arsimor të Ukrainës.




Universiteti Shtetëror Pedagogjik Ivan Franko Drohobych (DSPU)

Miratimi i Kornizës Institucionale për Mikro-Kredencialet

Në tetor 2025, DSPU prezantoi për vendimmarrësit institucionale Kornizën Institucionale për Mikro-kredencialet, një sistem i qartë dhe transparent për dhënien dhe njohjen e Mikro-kredencialeve, në përputhje me rekomandimet kombëtare. Senati Akademik i DSPU miratoi këtë dokument shumë të rëndësishëm, i cili vendos themelet për rrugë fleksibël të të nxënës të orientuar drejt së ardhmes.

Inagurimi i Studios së Medias

Më 13 janar 2025, DSPU hapi një studio moderne për prodhimin e kurseve me cilësi të lartë të bazuara në MOOC. Studioja ofron mbështetje për prodhimin e videove, dizajnin instruksional dhe asistencën teknike, duke u shndërruar në një qendër kryesore për zhvillimin e kurseve digjitale.



Përfundimi i Mikro-Kredencialit Pilot mbi Arsimin gjithëpërfshirës

Deri në mars 2025, ekipi i DSPU-së përfundoi Mikro-kredencialin e tij të bazuar në MOOC “Mësuesi në një Mjedis Edukativ Gjithëpërfshirës”, i përshtatur për t’u ofruar mësuesve strategji dhe mjete për të mbështetur nxënësit me nevoja të ndryshme arsimore. Ky proces pilot pasqyron angazhimin e DSPU-së për të avancuar praktikën e arsimit gjithëpërfshirës në Ukrainë.

Aktivitetet

DSPU prezantoi punën e saj në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, duke promovuar rolin e Mikro-kredencialeve në zhvillimin profesional të mësuesve. Ndër ngjarjet më të rëndësishme përmenden Forumi Arsimor i Rajonit të Lvivit dhe FORUM SOIS 2025.



Universiteti Shtetëror Pedagogjik Bogdan Khmelnitsky Melitopol (BK MSPU)

Hapja e studios për MOOC

Më 12 nëntor 2024, BK MSPU inauguroi një studio video të pajisur plotësisht për zhvillimin e Mikro-kredencialeve të bazuara në MOOC, e financuar me mbështetjen e projektit Erasmus+ CRED4TEACH. Studioja përfshin pajisje të avancuara për filmim dhe montazh, softuer të specializuar dhe mjete për krijimin e përmbajtjeve mësimore online me cilësi të lartë.

Kjo studio do të shërbejë si një qendër kryesore për prodhimin e Mikro-kredencialeve, duke integruar metoda digjitale inovative dhe duke mbështetur ngritjen e kapaciteteve të mësuesve përmes burimeve arsimore moderne dhe të aksesueshme.



Akademia Ukrainase e Pedagogjisë së Inxhinierisë (UEPA)

Hapja e studios për MOOC

Më 30 gusht 2024, UEPA inauguroi një studio të re MOOC në Kharkiv si pjesë e projektit Erasmus+ CRED4TEACH. Ceremonia e hapjes, ku morën pjesë udhëheqësit e universitetit, stafi i projektit dhe studentët,

nxori në pah angazhimin e UEPA-së për të avancuar të mësuarit digjital dhe për të nxitur bashkëpunimin në zhvillimin profesional të mësuesve në të gjithë Ukrainën.





Tryezë e rrumbullakët mbi kompetencat digjitale për mësuesit e arsimit profesional dhe parauniversitar

Më 11 shtator 2024, UEPA, në bashkëpunim me Universitetin Kombëtar "V.N. Karazin" në Kharkiv, organizoi një tryezë të rrumbullakët me fokus në forcimin e kompetencave digjitale të mësuesve të arsimit profesional dhe të shkollave të mesme përmes Mikro-kredencialeve të bazuara në MOOC. Prezantuesit ndanë njohuri mbi strukturën evropiane të Mikro-kredencialeve dhe hartimin e Mikro-kredencialit pilot të UEPA-s "Mësimdhënia Efektive Online". Tryeza ofroi një platformë të vlefshme për diskutim, shkëmbim përvojash dhe promovimin e përdorimit të mjeteve moderne digjitale në trajnimin e mësuesve në të gjithë Ukrainën.




Agjencia Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë (NQA)

Forcimi i themeleve për Mikro-kredencialet në Ukrainë

Në vitin 2024, Agjencia Kombëtare e Sigurimit të Cilësisë (NQA) ndërmori hapa të rëndësishëm për të mbështetur zhvillimin e Mikro-kredencialeve si pjesë e projektit Erasmus+ CRED4TEACH. Në qershor, Agjencia publikoi rekomandime kombëtare që inkurajojnë përdorimin e mundësive të të mësuarit afatshkurtër dhe të synuar si një mënyrë për edukatorët që të zhvillojnë aftësi të veçanta në përgjigje të nevojave të tregut të punës.

Këto rekomandime i dhanë institucioneve të arsimit të lartë një bazë të qartë për të formësuar kornizat e tyre institucionale. Ato u rishikuan nga NQA, e cila ofroi komente konstruktive bazuar në përvojën profesionale. Ky progres u prezantua gjithashtu gjatë një konference në Vlorë, Shqipëri, ku përfaqësues të Agjencisë nënvizuan rëndësinë e përputhjes së përpjekjeve kombëtare me standardet evropiane si pjesë e rrugës më të gjerë të Ukrainës drejt reformës arsimore dhe integritit.



Aspektet më të rëndësishme nga partnerët e CRED4TEACH: SHQIPËRIA

Mikro-Kredencialet të njohura si pjesë e Sistemit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional në Shqipëri

Në vitin 2024, Ministria e Arsimit dhe Sportit në Shqipëri miratoi një akt ligjor mbi zhvillimin e vazhdueshëm profesional (ZVP) të personelit arsimor, duke njohur zyrtarisht Mikro-kredencialet si një nga format e vlefshme të të nxënit profesional. Akreditimi i Mikro-kredencialeve në kuadër të këtij kuadri realizohet nga partneri i projektit CRED4TEACH, ASCAP – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar. ASCAP siguron që këto programe të përmbushin standardet kombëtare të cilësisë dhe të kontribuojnë në mënyrë të ndjeshme në zhvillimin Njohja ligjore dhe institucionale e Mikro-kredencialeve përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt integritetit të

mundësive fleksibël të të nxënit në sistemin arsimor shqiptar, në përputhje me prioritetet kombëtare arsimore. Ekipi i CRED4TEACH është krenar që është pjesë e këtij zhvillimi!

Dokumente Kombëtare që Mbështesin Mikro-Kredencialet në Shqipëri

Shqipëria finalizoi dy dokumente themelore për të udhëzuar integrimin e Mikro-kredencialeve në sistemin e saj arsimor dhe të formimit profesional. Korniza kombëtare për Mikro-Kredencialet përcaktoi konceptet kryesore, llojet dhe përbërësit, si dhe vendosi standardet për zhvillimin, vlerësimin dhe njohjen e tyre në përputhje me objektivat e zhvillimit të vazhdueshëm profesional (ZVP). Për të mbështetur zbatimin praktik të tij, në shtator 2024 u publikua Udhëzuesi Kombëtar për Mikro-Kredencialet, i cili ofron udhëzime të detajuara për hartimin, ofrimin dhe vlerësimin e programeve. Së bashku, këto dokumente ofrojnë një pikë reference të qartë për institucionet, agjencitë dhe universitetet që janë të angazhuara për të ofruar mundësi trajnimi të akredituara dhe të bazuara në kompetenca.




Aspektet më të rëndësishme nga partnerët e CRED4TEACH: MALI I ZI

Prezantimi i ndikimit të CRED4TEACH në ARSUM 25

Në konferencën ARSUM 25, e zhvilluar më 15–16 prill 2025 në Kotor, Prof. Maja Delibasic dhe Dr. Tamara Jovovic nga Universiteti Mesdhetar (UNIMED) prezantuan projektin CRED4TEACH. Prezantimi i tyre, i zhvilluar gjatë sesionit mbi iniciativat Erasmus+, tregoi arritjet më të fundit të CRED4TEACH në arsimin ndërkulturor dhe mësimdhënien e përzier. Ata angazhuan pjesëmarrësit e konferencës — përfshirë politikanë, studiues dhe edukatorë — në një dialog të

thelluar mbi integrimin e mjeteve dixhitale të mësimdhënies në klasat multikulturore. Puna e tyre pati jehonë të veçantë në kontekstin kulturor dinamik të qendrës kreative të Kotorit. Pjesëmarrja e tyre aktive jo vetëm rriti dukshmërinë e projektit, por gjithashtu hapi mundësi për bashkëpunim rajonal. Duke ndarë shembuj praktikë dhe metodologji mësimdhënieje të testuara në terren, të zhvilluara brenda CRED4TEACH, Maja dhe Tamara forcuan lidhjet me kolegë nga e gjithë Europa Juglindore. Angazhimi i tyre në ARSUM tregon



angazhimin e UNIMED për të avancuar kapacitetin e edukatorëve dhe pasqyron potencialin e fortë për partneritete të vazhdueshme dhe shkëmbim njohurish brenda kuadrit të Erasmus+ dhe fushës së arsimit kulturor.

Cilët janë hapat e ardhshëm?

Universitetet partnere po përgatiten për të pilotuar Mikro-kredencialet e tyre të bazuara në MOOC, duke shënuar një moment kyç në zbatimin praktik të mësimit fleksibël dhe të bazuar në kompetenca. Këto pilotime do të ndihmojnë në vlerësimin e efektivitetit të kurseve të zhvilluara dhe në mbledhjen e komenteve nga pjesëmarrësit për përmirësime të mëtejshme. Ndërkohë, pritet të vijojë edhe procesi i akreditimit të këtyre Mikro-kredencialeve, duke mundësuar njohjen e tyre formale brenda sistemeve kombëtare të Zhvillimit Profesional të Vazhduar (CPD).

Qëndroni të informuar për përditësimet dhe rezultatet!



Shiko faqen tonë
zyrtare të internetit:
www.cred4teach.eu

Na ndiqni:
Mësoni më shumë rreth projektit në:



Programi:
Erasmus+, Projekti KA 2
– Ndërtimi i
Kapaciteteve në
Arsimin e Lartë

Kohëzgjatja e projektit:
1 Qershor 2023 – 31 Maj
2026

**Koordinatori i
Projektit:**
Universiteti i
Shkencave të
Aplikuara
Fachhochschule
des Mittelstands
(FHM)



**Fachhochschule
des Mittelstands**



TALLINN UNIVERSITY



ANADOLU
UNIVERSITESI



Co-funded by
the European Union

Krijimi i këtij komunikimi është financuar nga Bashkimi Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm ato të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose të Agjencisë Ekzekutive për Arsimin dhe Kulturën Evropiane (EACEA). Bashkimi Evropian dhe Agjencia Ekzekutive për Arsimin dhe Kulturën Evropiane (EACEA) nuk janë përgjegjëse për këtë.